Alkooli - dezinfektim nga dezinformimi

Duke marrë parasysh faktin se media pasqyron vetëm një pjesë të realitetit, në mënyrën e vet, një nga faktorët më të rëndësishëm që duhet të posedojmë, është njohuria mediale. Qytetarët marrin çdo ditë shumë informacione mbi tema të ndryshme të jetës shoqërore përmes mediave tradicionale dhe sociale. Mes tyre përfshihen edhe dezinformata ose përmbajtje të pavërteta. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të interpretohen mesazhet që marrim përmes kanaleve mediatike. Teksti i çdo gazetari duhet të lexohet, rishikohet, kuptohet, analizohet dhe interpretohet në mënyrë kritike. Por shumë njerëz janë kapur në një kurth të quajtur dezinformim. Këto janë informacione që kanë përmbajtje të pasaktë ose të paverifikuar dhe shpesh krijohen me qëllim dashakeq. Lloji më i rrezikshëm i dezinformimit është ai që përmban të vërteta të pjesshme, I krijuar për t'i mashtruar njerëzit. Shumica prej tyre e lexojnë vetëm fjalinë e parë përpara se të shpërndajnë përmbajtjen.

Duke përcjellur lajmet që lidhen me KOVID-19, një temë që është më e rëndësishmja këto ditë dhe prek tërë popullsinë e globit, ne hasëm në një informacion me rreth 13,000 shikime dhe një titull që menjëherë na tërhoqi vëmendjen: **Një Britanik në Kinë u shërua nga virusi Corona sepse pinte nje pije alkoolike?** - botuar në portalin : tocka.com.mk.

Pas një studimi më të thelluar, një titull plotësisht të ngjashëm ose pjesërisht të ngjashëm, kemi vërejtur në portalet e tjera në internet, si më poshtë: www.mtm.mk, www.24info.mk, www.a1on.mk, www.localno.mk, www.makfax.mk, www.puls24.mk, www.kurir.mk, www.vecer.mk, www.slobodenpecat.mk, www.vesnik.com, www.sitel.com.mk dhe në www.infomax.mk.

Tani që i gjithë publiku po vëzhgon zhvillimet me pandeminë, është plotësisht joetike dhe joprofesionale përhapja e dezinformatave për këtë temë. Cfarë është joetike në lajmin që analizojmë? Pretendimi nga 13 portale në internet se ekziston një kurë për koronavirusin. Dhe cili është dezinformimi? Është pretendimi se ilaçi është një pije alkoolike. Dhe diku u nisur nga titulli për analizë do të marrim lajmin e publikuar në portalin tocka.com.mk.

Ajo tërheq vëmendjen dhe, si titujt tipikë të klikimeve, nuk mund të pritet që informacioni që lexohet në përmbajtje të jetë serioz. Megjithatë, nga rishikimet e shumta kemi arritur në përfundimin se ky lajm ka tërhequr vërtet vëmendjen e një pjese të madhe të publikut. Duke lexuar më tej tekstin, mund të zbuloni se kura për koronën është uiski me mjaltë, sipas pretendimeve të British Conor Reed. Pothuajse të gjitha portalet në internet që kanë botuar këtë informacion nuk ndryshojnë aspak në përmbajtjen e tekstit. Gjithashtu është e nevojshme të theksohet se deklarata e mëposhtme është më e dukshme nga i gjithë teksti gazetaresk:

> - "Kam përdorur inhalator që më ndihmoi me kollën dhe piva uiski të nxehtë me mjaltë derisa e harxhova. Është një kurë e vjetër, por duket se ka funksionuar. "Unë nuk pranova të përdor antibiotikë sepse nuk doja asnjë ilaç farmaceutik."


Kjo deklaratë, me disa fjalë të ndryshuara në njërën prej fjalive mund të shihet në të gjitha 13 portalet në internet, gjë që tregon se deklarata është dhënë për një portal të huaj në internet, dhe është i ashtuquajturi: www.thesun.co.uk.

Gazetarët tanë kanë përkthyer të gjithë përmbajtjen pa kontrolluar besueshmërinë e lajmit, vërtetësinë e asaj që është paraqitur për publikun dhe burimin nga i cili është marrë.

Çdo informacion pa kontrollimin e fakteve themelore është i diskutueshëm dhe mund të jetë dezinformim.

Kjo është arsyeja pse ne kemi bërë disa hulumtime në lidhje me deklaratat publike të bëra nga personi mbi të cilin bazohet i gjithë lajmi, përkatësisht britanikun Conor Reed. Nëse përmbledhim atë që është thënë deri më tani, lajmet u publikuan në portalin The SUN më 3 shkurt 2020, dhe saktësisht në të njëjtën datë u transmetua edhe nga portalet maqedonase.

Sidoqoftë, gjithashtu kemi vërejtur se qarkullon një video nga programi i përditshëm televiziv britanik This Morning, i cili transmetohet në ITV në Britaninë e Madhe. Dy gazetarët që drejtuan shfaqjen i dhanë një intervistë të shkurtër britanikut. Në video, njeriu, i cili është shëruar nga koronavirusi, thotë se efekti i një pijeje alkoolike të nxehtë me mjaltë ndikon në luftën kundër ftohjes, zvogëlon dhimbjet e fytit dhe lehtëson simptomat e gripit. Por ajo që është më e rëndësishmja dhe me të vërtetë vlen të theksohet, thotë ai se kjo pije nuk është një kurë për koronavirusin.



„Не сакав да пијам лекови“: Британец од Вухан вели дека се излечил од вирусот благодарение на бизарен рецепт!
Локално | пред 2 месеци
Дваесет и петгодишен британски државјанин, Конор Рид, наставник по англиски јазик од Ландидн, Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излечил...

Британец тврди дека се излекувал од коронавирусот со виски
Слободен Печат | пред 2 месеци
Тој во Кина работи веќе три години, а во Вухан е во последните шест месеци. Британец тврди дека успешно се излечил од коронавирусот без да користи никакви лекови. Конор Рид (25) кој е учител од Велс и работ...

Тврди дека се излечил од коронавирусот, виски било неговиот спас
Курир | пред 2 месеци
Тврди дека се излечил од коронавирусот, виски било неговиот спас Британец тврди дека успешно се излечил од коронавирусот без да користи никакви лекови. Конор Рид (25) кој е учител од Велс и работи в...

Британец се излекувал од коронавирусот благодарение на стар лек
Макфакс | пред 2 месеци
Дваесет и четиригодишниот Британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излекувал пиејќи виски со мед. Рид...

Британец тврди дека се излекувал од коронавирус со виски со мед
А1оп | пред 2 месеци
Дваесет и петгодишен британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Ландидн, Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека бил излекуван со „чаша топло...

Британец се излекувал од коронавирусот благодарение на стар лек
Весник | пред 2 месеци
Дваесет и четиригодишниот Британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излекувал пиејќи виски со мед. Рид...

Британец во Кина се излечил од Корона вирусот затоа што пиел еден алкохолен пијалок?
Точка | пред 2 месеци
Првиот Британец кој се заразил со смртоносниот Корона вирус, кој досега усмрти 362 лица тврди дека се излечил без користење на лекови. Имено, 25-годишниот Конор Рид, професор од Велс кој работи во Вухан, пред...

“ТОПЛО ВИСКИ СО МЕД”: Британец тврди дека од корона вирусот се излечил без лекови
Infomax | пред 2 месеци
Првиот Британец кој се заразил со смртоносниот Корона вирус, кој досега усмрти 362 лица тврди дека се излечил без користење на лекови. Имено, 25-годишниот Конор Рид, професор од Велс кој работи во Вухан, пред...

Британец се излекувал од коронавирусот благодарение на стар лек
МТМ | пред 2 месеци
Дваесет и четиригодишниот Британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излекувал пиејќи виски со мед. Рид...

Британец се излекувал од коронавирусот благодарение на стар лек
24 Инфо | пред 2 месеци
Дваесет и четиригодишниот Британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излекувал пиејќи виски со мед. Рид...

Британец се излекувал од коронавирусот благодарение на стар лек
Вечер | пред 2 месеци
Дваесет и четиригодишниот Британец Конор Рид, наставник по англиски јазик од Велс, се заразил со смртоносниот коронавирус во Вухан пред околу два месеци, но тврди дека се излекувал пиејќи виски со мед. Рид...

Portali në internet dialymail.co.uk ka botuar gjithashtu një artikull në lidhje me këtë njeri, me temën "Si është të kesh një koronavirus?"

Ky artikull përshkruan ndjenjat, simptomat dhe llojin e dhimbjes që britaniku ndjeu që nga dita e parë që u sëmur deri në ditën kur u shërua. Në fund të vetë artikullit, dita 72, data: e martë, 4 shkurt 2020; mund të lexoni tekstin e mëposhtëm:

> Day 72 — Tuesday, February 4: It seems the newspapers think it's terrific that I tried to cure myself with hot toddies.
>
> I attempt to explain that I had no idea at the time what was wrong with me — but that isn't what they want to hear.
>
> The headline in the New York Post says, 'UK teacher claims he beat coronavirus with hot whisky and honey.'
>
> I wish it had been that easy.

Fakti që lajmet u publikuan nga media e huaj ose portalet në internet, në këtë rast www.thesun.co.uk, nuk do të thotë se është i saktë dhe i vërtetë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të plasohet pa u verifikuar lajmi nga ana e mediumeve tona , veçanërisht gjatë kësaj kohe pandemie, kur pothuajse të gjithë njerëzit janë të tmerruar dhe kërkojnë metoda të ndryshme për të parandaluar infeksionin ose kërkojnë kurimin.

Tani le të kthehemi te lajmi që po analizojmë, i publikuar në tocka.com.mk. Hapi tjetër ishte kontrollimi i fotove. Me ndihmën e një detektori të besueshëm fotografish, zbuluam se lajmet origjinale për të cilat synonin këto imazhe nuk kishin asnjë lidhje me temën e lajmit. Imazhi i parë është nga një titull lajmesh: "Pacienti i parë nga Odisha", dhe i dyti për turmat në aeroportet kineze.

Ky lajm prek dhe juintereson të gjithë njerëzve në mbarë botën, pasi në një farë mënyre ofron një kurë për pandeminë që përhapet gjithnjë e më shumë çdo ditë, dhe numri i vdekjeve është duke u rritur në mënyrë dramatike nga dita në ditë. Jo të gjithë do të preken nga ky mesazh. Disa njerëz do të bëjnë hulumtime më të mira dhe do të zbulojnë se ky është dezinformim. Sidoqoftë, ka individë që do të besojnë, dhe kjo mund të çojë më tej në mosbesim në shëndet dhe mosbindje ndaj mjekëve, duke çuar në një gjendje kritike shëndetësore të personave që nuk duhet të konsumojnë alkool, por ata do ta bënin të njëjtën si trajtim ose msëmbrojtëse nga COVID – 19. Sidoqoftë, pasojat mund të jenë fatale.

Duhet pasur parasysh se mungesa e informacionit kryesor si: autori i lajmit, personi mbi të cilin bazohet dhe informacion më i detajuar për të, fotografia dhe deklarata e tij e besueshme, si dhe mungesa e konfirmimit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ose institutet kërkimore që kryejnë testet e virusit do të thotë se duhet të dyshojmë për vërtetësinë dhe besueshmërinë e të gjitha lajmeve. Lajmet e analizuara, nga ana tjetër,

konfirmojnë edhe një herë se duhet t'i kushtojmë vëmendje besueshmërisë dhe vërtetësisë së asaj që shkruajmë, në momente të tilla frike dhe paniku, veçanërisht kur bëhet fjalë për jetën njerëzore dhe shëndetin e njeriut.

Ky është vetëm një shembull që njohja mediale mund të na kushtojë shumë. Ndonjëherë humbje parashë, panikë, frikë, ankth, depresion, mosnjohje. Dhe në këtë rast, jeta vlen.

Kjo është arsyeja pse u bëjmë thirrje nga më I madhi deri te më i vogli :

"Jini veçanërisht të kujdesshëm dhe kontrolloni besueshmërinë dhe vërtetësinë e asaj që plasohet si një produkt gazetaresk. Gjithmonë lexoni me kujdes dhe me mençuri! Njohja mediale është përgjegjësi e çdo qytetari! "

Autorët:

Kristina Jovanovska, 18 vjet

Angela Naumçeska, 18 vjet